REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më __.__.2026

PROJEKT – VENDIM
Nr. __, datë __.__.2026

"MBI NJË NDRYSHIM TË PLANIT VENDOR, PËR HEQJEN E KUFIZIMIT TË PRONËS ME NR. 12/399, VOLUME:17, FAQE 10. LLOJI I PASURISË ARË, ME SIPËRFAQE TOTALE 4030.6 M2,ZK NR. 8552, INDEKSI I HARTËS/: (KJ), M.N – 2.3, ME ADRESË KAVAJË"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodi të Procedurës Administrative, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligji nr. 8561/1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", VKM nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" e përditësuar

TË VENDOSI:

1. Mbi ndyshimin e planit vendor të VKB nr. 96, datë 19.12.2017, për heqjen e kufizimit të pronës me nr. 12/399, volume: 17, faqe 10, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe totale 4030.6 m^2, ZK nr. 8552, indeksi i hartës/: (KJ), M.N – 2.3, me adresë Kavajë.
2. Ky Projekt – Vendim, pasi të miratohet nga Këshilli Bashkiak, hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore".
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kavajë për ndjekjen e procedurave të këtij Vendimi për miratimin në Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

DREJTORIA LIGJORE
Helidon PLAKU

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Dëshira QATO

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
Marjus KOLA

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
Meri BITURKU

KRYETARI
Fisnik QOSJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot. **Datë, __.__.2026**

Relacion mbi ndryshimin e planit vendor të VKB nr. 96, datë 19.12.2017, për heqjen e kufizimit të pronës me nr. 12/399, volume:17, faqe 10, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe totale 4030.6 m2, ZK nr. 8552, indeksi i hartës/: (KJ), M.N – 2.3, me adresë Kavajë.

Kryetarit të Bashkisë
Z. Fisnik Qosja

Pranë Bashkisë Kavajë ka ardhur një shkresë me nr. 6045 Prot., dt. 16.12.2025, nga znj. Enkelejda Hoxha, lindur më dt. 18.09.1973, banuese në Kavajë, me nr. Personal H35918057V. Subjekti në fjale pretendon cënimin e të drejtës për gëzimin e pronës me nr. 12/399, volume: 17, faqe 10, lloji i pasurisë arë, me sipërfaqe totale 4030.6 m2, ZK nr. 8552, indeksi i hartës/: (KJ), M.N – 2.3, me adresë në Kavajë me qëllim zgjerimin e varrezave Kavajë, pa u njoftuar paraprakisht.

Në ankesën e paraqitur nga znj. Enkelejda Hoxha, deklarohet se, pronës së fituar me kontratë dhurimi, në vitin 2020, së cilës i janë paguar të gjitha taksat dhe detyrimet ndaj shtetit, i është cënuar e drejta për gëzimin e saj, pa u njoftuar nga Bashkia Kavajë. Sipas ankueses, ky kufizim nuk është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për aq kohë sa ky bllokim ka më shumë se 8 vjet, nuk është përdorur si mjet efektiv nga Bashkia Kavajë, apo e vetmja mundësi që të vlerësohet interes i lartë publik.
Gjithashtu, në ankesë qytetarja shprehet se e ka dëmtuar ekonomikisht për vite me radhë duke mos lejuar zhvillimin e një biznesi apo për përdorime të tjera në pronën e saj si cdo qytetar tjetër.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, pasi u njoh me rastin në fjalë, nëpërmjet shkresës nr. 08/2 Prot., dt.23.01.2026, verifikoi se në këtë pronë është hequr e drejta e gëzimit dhe përdorimit të saj sipas VKB nr. 96, datë 19.12.2017. Drejtoria e Shërbimeve Publike shprehet se mbi këtë pasuri nr. 12/399, me sipërfaqe 4030.6 m^2, ZK nr. 8552, **nuk i nevojitet** Bashkisë

Kavajë për parcela varrimi sepse:
Nga ana perëndimore e saj ndodhen sipërfaqe të tjera të cilat janë më të përshtatshme për parcela varrimi.

Përmbledhëse

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pasi mori në shqyrtim rastin në fjalë duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Administrative, Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Ligjit nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe duke u bazuar në MEMO – n, e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nga ku konstatohet se kjo pasuri nuk i nevojitet Bashkisë Kavajë, **kërkohet heqja e kufizimit të kësaj prone**.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Dëshira QATO

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Marjus KOLA